



Prishtinë: 19.11.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1454_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2244_10_21** të dt. 05.10.2021;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 21.10.2021;

në seancën e mbajtur më datë 19.11.2021 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e konsumatorit V.L, nga Komuna e Prishtinës.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2244_10_21, i datës 05.10.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 05.10.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2244_10_21, me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit V.L nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e faturës së energjisë elektrike të dt. 20.01.2020, për shkak të kyçjes ilegale në njehsorë.

E pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori V.L, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Konsumatori nuk pajtohet me korigjimin e bërë, pasi që dyshon që njehsori i kyçur ilegalisht ka shpenzuar me shumë energji elektrike, se sa ajo që është korigjuar nga DMK-ja;
- Kërkon nga Bordi që kjo lëndë të trajtohet në mënyrë të duhur.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se njehsori i kyçur ilegalisht ka shpenzuar më shumë energji elektrike, Bordi i ZRrE-së thekson se, pasi që ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se, duke u bazuar në Procesverbalin mbi inspektimin e njehsorit të dt. 08.01.2020, konsumatori Arben Mehmeti, i shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit, është rikyçur ilegalisht në njehsorin e konsumatorit V.L, me shifër DPR – 17622. Po ashtu, duke iu referuar Procesverbalit mbi inspektimin



e njehsorit elektrik të dt. 30.01.2020, ZRrE ka gjetur se punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë inspektimin e njehsorit elektrik dhe kanë konstatuar se: *“Hyrjet daljet janë në rregull dhe nuk është vërejtur ndonjë parregullësi, ani pse konsumatori është ankuar se një njehsor është lidhur ilegalisht, por që për momentin nuk është vërejtur ndonjë parregullësi”*.

Meqenëse, kemi të bëjmë me kyçje ilegale të një konsumatori i cili ka qenë i shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit, Bordi i ZRrE-së thekson se, DMK-ja si shkallë e parë, me të drejtë ka konstatuar se KESCO ka gabuar në rastin e përshkrimit të ankesës si dhe marrjes për bazë të rrjedhës së energjisë elektrike, duke mos e marrë për bazë kyçjen ilegale të konsumatorit. Rrjedhimisht, me të drejtë është aprovuar ankesa e konsumatorit dhe është obliguar KESCO që ta korrigjoj faturën e dt. 20.01.2020, duke e zbritur TL = 170 kWh dhe TU = 174 kWh.

Pas analizimit të Rrjedhës së Energjisë Elektrike dhe faturës së kontestuar, Bordi i ZRrE-së gjen se, faturimi i shpenzimeve për periudhën 01/2020 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, sepse kemi të bëjmë me kyçje ilegale të një konsumatorit tjetër. Bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike vërtetohet se shpenzimi i konsumatorit për periudha të njëjta kohore është: periudha 01/2017 është **754 kWh/muaj**, periudha 01/2018 është **1,032 kWh/muaj**, periudha 01/2019 është **1,230 kWh/muaj**, periudha 01/2020 është **1,067 kWh/muaj** kurse për periudhat e me vonshme periudha 01/2021 është **395 kWh/muaj**. Bordi ka shqyrtuar edhe shpenzimet e konsumatorit me shifër DPR-17617 dhe konstaton se ky konsumatorë për periudhën 01/2020 ka dallim të lartë me shpenzimet e faturuara për periudhat e njëjta të me hershme dhe të me vonshme ku: 01/2017 është **1,922 kWh/muaj**, periudha 01/2018 është **1,956 kWh/muaj**, periudha 01/2019 është **2,234 kWh/muaj**, kurse për periudhën kontestuese është **435 kWh/muaj** dhe periudhën 01/2021 është **181 kWh/muaj**.

Andaj, duke u bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 0735355 datë 08.01.2020 me të cilën vërtetohet se konsumatori me shifër DPR-17617 ka qenë i kyçur në mënyrë ilegale në shifrën DPR-17622 konstaton se shpenzimet e faturuar për periudhën janar 2020 në shifrën DPR-17622 nuk mund të paraqet shpenzim real. Po ashtu KEDS ka ofruar procesverbalet e shkyçjes të shifrës DPR-17617 me të cilat vërtetohet se konsumatori është shkyçur nga rrjeti me datë 30.12.2019. DMK duke pasur parasysh të gjitha këto argumente si dhe faturimin e periudhës janar 2020 në shifrën DPR-17622 konstaton se fatura e periudhës 01/2020 duhet të korrigjohet për **TU=170 kWh** dhe **TU=174 kWh** duke marrë për bazë kyçjen ilegale të konsumatorit me shifër DPR-17617 nga periudha 30.12.2019 deri me 08.01.2020.

Pra, pretendimi i konsumatorit se korrigjimi i DMK-së nuk është i saktë, si i tillë nuk qëndron, sepse ZRrE ka analizuar me kujdes Rrjedhën e Energjisë Elektrike të të dy konsumatorëve, dhe duke u bazuar në shpenzimet e evidentuara, me të drejtë ka konstatuar se konsumatori duhet të korrigjohet për TL = 170 kWh dhe TU = 174 kWh.

ZRrE ka shqyrtuar edhe përgjigjen e KESCO-s të datës 04.02.2020 dhe konstaton se KESCO ka gabuar në rastin e përshkrimit të ankesës si dhe marrjes për bazë të rrjedhës së energjisë elektrike duke mos e marrë për bazë edhe kyçjen ilegale të konsumatorit me shifër DPR-17617 me çka edhe do të rezultonte korrigjimi i nevojshëm pasi që bazuar në nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjera, sipas strukturës*



tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.

Andaj, në harmoni me nenin 48 të Ligjit nr.05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, Bordi i ZRRE-së i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e ankuesit dhe i ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe provat që lidhen më rastin në fjalë dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.11.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit V.L,
- Arkivit të ZRRE-së